



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 888 Prot.

Tiranë më 8.4. 2021

VENDIM

Nr. 5, datë 30.03 2021

*“Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, për vitin akademik 2021-2022”*

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3; neni 25, pika 7; neni 37, pikat 1 e 2; neni 38, pika 1 dhe pika 3; në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar, pika 2.7, gërma a, b dhe c, në Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 14, pika 5, gërma “d” dhe neni 31, gërma “q”; si dhe në propozimet e njëjësive kryesore të UT-së, në mbledhjen e datës 30.03.2021 Senati Akademik i Universitetit të Tiranës;

VENDOSI:

1. Të miratojë kuotat e pranimit në Universitetin e Tiranës për vitin akademik 2021-2022, në programet e studimeve të ciklit të parë Bachelor dhe në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë, me kohë të plotë (tabela 1 bashkëlidhur), si më poshtë vijojnë:
  - a) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë brenda vendit: **5133 kuota**
  - b) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë nga trojet shqiptare: **249 kuota**
  - c) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë shtetas të huaj: **48 kuota**
  - d) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë nga kategoritë e veçanta (me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin e jetimit, si dhe kandidatët studentë romë dhe egjiptianë): **160 kuota**
  - e) Kuotat e pranimeve për kandidatët studentë që aplikojnë për transferim studimesh: **206 kuota**
  - f) Kuotat e pranimit për kandidatët studentë që aplikojnë për një program të dytë studimi: **95 kuota**
2. Kuotat e perealizuara të pikave 1/b; 1/c; 1/d; 1/e dhe 1/f do të shpërndahen nga Rektorati sipas kërkesave të njëjësive kryesore të UT-së.
3. Ky vendim i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Prof. Dr. Artan Hoxha